

1 E enjte, 28 mars 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Fillon në orën 10.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqitni lëndë.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuara kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa
12 të fillojmë kam një pyetje, kam edhe një koment për arsye
13 planifikimi që lidhet me nevojën për pasjen e një dëshmitari
14 rezervë për javën që vjen.

15 E di që javën që vjen ne do të kemi një seancë për ditë
16 ndërkohë që dëshmitari që kemi të planifikuar për javën që
17 vjen është ai me numër 4739 dhe paraprakisht planifikohen 14
18 orë gjithsej, nga të gjitha palët. Në qoftë se do të jetë e
19 mundur ne dëshirojmë që të përfundojmë me këtë dëshmitar sepse
20 përkundrazi i takon që duhet që dëshmitari të kthehet pas dy
21 javësh pasi kemi pushim për dy javë nga seancat.

22 Do ju kërkoja palëve që të paktën të rivlerësonin kohën
23 që ata planifikojmë për të përdorur me këtë dëshmitar. Ose së
24 pari, dua t'ju pyes në qoftë se keni ndonjë ndryshim sa i
25 takon kohës që ju duhet për kundërpjetjet ose për pyetjet

1 kryesisht nga Prokuroria.

2 Fillojmë me Prokurorinë, z. Ferdinandusse, ndoshta nuk
3 është dëshmitari juaj, por nuk e di në qoftë se mund të na
4 jepni një përgjigje, ose në qoftë se nuk e keni përgjigjen
5 mund ta diskutoni me kolegët dhe mund të na thoni më vonë.

6 Ndokush tjetër a dëshiron që t'i përgjigjet kësaj pyetje?

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë do të jem personi i parë që
8 do t'i bëj kundërpjetje dëshmitarit të radhës. Planifikoj deri
9 tani katër orë. Mbase më duhet që të bëj një lloj koordinimi
10 gjatë pushimit në mënyrë të tillë që të shkurtojmë orët në
11 total, orët gjithsej që ne kemi parashikuar si ekipe të
12 Mbrojtjes.

13 Nuk e di në qoftë se duhet të fillojmë sot apo jo. Nuk e
14 di në qoftë se është mirë që të fillojmë me këtë dëshmitar sot
15 apo jo.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të ishte
17 pak si e tepër në fakt në qoftë se do të përgatiteshim që të
18 fillonim me këtë dëshmitar sot.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dëshironim që ta dinim në mënyrë
20 të tillë që të bëjmë përgatitjet e nevojshme. Megjithatë,
21 sikurse e thashë do të konsultohem edhe me ekipet e tjera dhe
22 pastaj do ju tregojmë për kohën.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Nuk dua që të më thoni një kohë, por gjithsesi dua që të
25 bisedoni me njëri-tjetrin dhe pastaj të martën të na thoni

1 sesa kohë ju duhet për arsye planifikimi. Dhe

2 Dhe siç e thatë do të ishte mirë edhe për dëshmitarin që
3 kemi këtu përpara, pra dëshmitarin e sotëm domethënë që në
4 qoftë se do të përfundonim sot do të ishte shumë mirë.
5 Megjithatë, në qoftë se nuk përfundojmë dot, nuk përfundojmë
6 dot. Do të vazhdojmë kur t'i vijë radha javën që vjen.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndoshta duhet që të jem i qartë
8 tërësisht. Më lejoni të them që do ishte mirë që ne të bëjmë
9 një pushim të shkurtër, të bëjmë një diskutim midis ekipeve të
10 Mbrojtjes dhe t'ju sugjerojmë një kohë, ndoshta edhe të
11 premtën, në qoftë se nuk e bëjmë dot sot këtë gjë, në mënyrë
12 të tillë që ju ta keni më të qartë sesa kohë na duhet me
13 dëshmitari e radhës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
15 Asistente, na sillni dëshmitarin.

16 Do të vazhdojmë me pyetjet e Trupit Gjykses.

17 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ndërkohë që presim që
18 dëshmitari të vijë në sallë, besoj që e keni parë emailin që
19 ju keni dërguar sot në mëngjes. Doja t'ju pyesja në qoftë se
20 do t'i përgjigjeni pyetjes së bërë në emailin e dërguar sot,
21 lidhur me dëshmitarin rezervë sot edhe sa i takon pasojave
22 logjistike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do mundohemi
24 t'ju japim një përgjigje gjatë ditës sot lidhur me këtë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, besoj që koha ime

1 do të jetë më e shkurtër sesa ajo që ishte parashikuar
2 paraprakisht për dëshmitarin e javës tjetër. Kështu që besoj
3 që do jem më pak sesa dy orë e gjysmë, mbase një orë, një orë
4 e pak, planifikoj.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi ndryshim nga planifikimi
7 paraprak për kundërpyetjet për dëshmitarin. Na duhet 3.5 orë.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] As nga ana jonë nuk kemi
9 ndryshim të kohës që na duhet për të bërë kundërpyetje për
10 dëshmitarin e radhës.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
13 Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
16 vazhdojmë sot me pyetjet e Gjykatësve. Mund të ketë edhe
17 pyetje plotësuese nga ekipet e Mbrojtjes në vartësi të
18 pyetjeve që do t'ju bëhen nga anëtarët e Trupit Gjykses.
19 Vlerësojmë që sot do të përfundojmë me dëshminë tuaj. Besoj që
20 ja u thashë edhe dje këtë gjë, por mendoj që do të përfundojmë
21 sot.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, vërtetë ma thatë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që
24 në qoftë se nuk i kuptoni pyetjet mund t'i kërkonit lirisht
25 palëve që t'ju bëjnë sqarimet përkatëse.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykues (Vazhdim)

Faqe 5

1 Ju lutem, duhet të thoni se cila është baza e njohurive,
2 fakteve dhe rrethanave për pyetjet që do t'ju bëhen. Ju kujtoj
3 që jeni ende nën detyrimin për të thënë të vërtetën sikurse
4 është thënë në betimin solemn prej jush.

5 Po ashtu, ju lutem flisni përpara mikrofonit dhe prisni
6 pesë sekonda përpara se të jepni përgjigjen dhe më pas duhet
7 të flisni ngadalë në mënyrë të tillë që përkthyesit t'ju
8 kapin.

9 Tani vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Mettraux.

10 Gjykatësi Mettraux, fjala për ju.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
12 Gjykatësi Smith.

13 DËSHMITARI: SHAUN BYRNES [Vijon]

14 Pyetje nga Trupi Gjykues: [Vazhdim]

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Byrnes.

16 PË. Mirëmëngjes.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dje ne kaluam gjashtë
18 incidentet bashkë. Pra diskutuam për gjashtë incidentet. Tani
19 dua që të flasim për incidentin që kishte të bënte me
20 gazetarët e Tanjugut, z. Radosevic dhe Dobricic. Dhe është e
21 vërtetë që ju i nxorët ato përmes trojkës, apo jo?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E dimë që ju keni qenë i
24 pranishëm në kohën e lirimit dhe keni thënë që ka pasë edhe
25 gazetarë të pranishëm në momentin kur janë liruar këto dy

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 6

1 gazetarë. Pyetja për ju është kjo: A i keni thirrur ju

2 gazetarët që ishin të pranishëm në këtë rast?

3 PË. Jo.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë që të
5 prezumohet që UÇK-ja t'i ketë thirrur gazetarët që ishin të
6 pranishëm?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se ka qenë
9 kështu, a mund të na thoni se çfarë interesi do të kishte
10 pasur UÇK-ja që ta bënte publik këtë rast?

11 PË. Nuk e kuptova pyetjen. A mund ta përsërisni edhe një
12 herë?

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas mendimit tuaj pse ka
14 dalë UÇK-ja -- të jenë të pranishëm gazetarë kur u liruan dy
15 gazetarët e Tanjugut?

16 PË. Unë thjesht mund të them mendimin tim, mund të spekuloj.
17 Mua më dukej sikur ata donin që të kishin një lloj publiciteti
18 pozitiv për mënyrën se si ishin trajtuar këta dy gazetarë
19 serbë në veçanti. Ata mendonin që kishin bërë gjënë e duhur.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Si e keni interpretuar ju,
21 praninë e Sokol Bashotës, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm që
22 ishte i pranishëm aty në atë rast, pra kur u liruan dy
23 gazetarët?

24 PË. Sipas përvojës time, ai zakonisht ishte thujse gjithmonë
25 i pranishëm në ngjarje ose veprimtari të cilat përfshinin

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 7

1 KDOM-in.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe pse mendoni, dhe
3 sigurisht në qoftë se e dini sepse në qoftë se nuk e dini mund
4 të na thoni që nuk e dini. Pse mendoni ju që Shtabi i
5 Përgjithshëm ka dërguar një anëtar të vet të jetë i pranishëm
6 në rastin e lirimit të dy gazetarëve të Tanjugut, domethënë dy
7 gazetarëve që ju dhanë juve?

8 PË. Edhe lidhur me këtë pyetje, thjesht mund të spekuloj se
9 nuk e di me siguri. Por, ai ishte personi i caktuar nga Shtabi
10 i Përgjithshëm që të merrej me KDOM-in ose të kishte
11 marrëdhënie me KDOM-in dhe mendoj se kjo ishte arsyeja pse ai
12 ishte i pranishëm në këtë rast.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të vazhdoj me
14 incidentin numër tre. Është incidenti që përfshin aktivistët e
15 LDK-së, z. Desku dhe z. Kastrati. Edhe në këtë rast ju na keni
16 thënë që e keni trajtuar këtë rast përmes trojkës. A është e
17 vërtetë kjo?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që
20 të paraqesë në ekran provën materiale P1067. Ky është një
21 kabllogram që e keni parë dhe e keni komentuar disa herë deri
22 tani, Dëshmitar. Mban datën 3 nëntor 1998.

23 Të shohim faqen 075307.

24 Dëshmitar, a mund t'i hidhni një sy paragrafit që keni
25 këtu, duke u përqendruar te pjesa ku fillon me fjalën "Për më

1 tepër ...".

2 PË. A mund të më thoni është në fillim të paragrafit që duhet
3 të filloj të lexoj apo jo?

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është fjalia e parë e
5 plotë që fillon mbas -- tek rreshti i tretë ku thuhet që:

6 "Për më tepër UÇK-ja arrestoi ...". Jo. Pra, "Policia
7 ushtarake kishte arrestuar dy anëtarë të lidërshepit të LDK-së
8 në Malishevë më 30 tetor."

9 Nuk e di e lexoni këtë fjali, Dëshmitar?

10 PË. Jo, nuk e shoh ku është. Ajo çfarë kam këtu përpara është
11 paragrafi 2.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo. Duhet të kesh një
13 paragraf që fillon në fillim me fjalën "Page 4" ose "Faqja 4".

14 PË. Po. E pashë, e pashë tani.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Ju lutem
16 shiheni, lexojeni pak këtë.

17 PË. "Për më tepër, 'policia sekrete' arrestoi dy anëtarë të
18 lidërshepit të LDK-së në Malishevë më 30 tetor". Dhe vazhdohet
19 më andej që "Mahmuti konfirmoi që 'arrestimet' nuk janë bërë
20 për motive ose për arsye politike, por sepse të dy zyrtarët e
21 LDK-së, Cen Desku dhe Jakup Krasniqi [Sipas përkthimit] kishin
22 'bashkëpunuar' me policinë serbe."

23 Nuk e di doni që të vazhdoj më tej me leximin apo jo?

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, vazhdoni më tej.

25 PË. "Mahmuti pretendoi se Desku dhe Kastrati ishin 'në burg'

1 dhe se ishin 'mirëtrajtuar'. Ai tha se ata lejoheshin që të
2 zgjidhnin avokatin e tyre për t'i mbrojtur ata në procesin
3 gjyqësor që do të mbahej në vijim. Zhvillime të tilla ngrenë
4 pyetje shqetësuese sa i takon angazhimit të UÇK-së për të
5 gjetur një zgjidhje paqësore në këtë krizë dhe gatishmërisë së
6 saj për të toleruar palë të tjera dhe opinione të tjera.
7 Shkurtimisht, UÇK-ja dukej e interesuar vetëm për përmirësimin
8 e imazhit të vet publik dhe me ndërkombëtarët dhe për forcimin
9 e kontrollit të vet mbi Kosovën."

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të përfundoni këtu.

11 Lidhur me këtë pjesën e fundit që sapo lexuat, a pajtohet
12 kjo me atë çfarë ju kujtohet juve t'ju ketë thënë z. Mahmuti
13 lidhur me këtë rast?

14 PË. Po, pajtohet.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa i takon pjesës së
16 fundit a i qëndroni po të njëjtës analize që keni pasqyruar në
17 këtë paragraf z. Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që
20 të paraqesë në ekran tani provën materiale P303. Në versionin
21 në anglisht do të jetë në faqen e dytë, ndërkohë që në
22 versionin shqip mund ta shikoni në të majtë të ekranit.

23 Dëshmitar, sa për të dhënë pak kontekst, kjo është një
24 konferencë -- është një kumtesë që është kumtesa numër 4 e
25 Policisë Ushtarake të UÇK-së. Dhe ka dalë me dalë 5 nëntor

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 10

1 1998. Dhe është botuar me datën 1 nëntor 1998. Do ju kërkoja
2 që ta lexonit pak përmbajtjen e kësaj kumtese. Pasi ta keni
3 lexuar ju lutem na e thoni, Dëshmitar.

4 PË. E lexova.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dy pyetje paraprake. A
6 e keni parë në atë kohë këtë dokument, Dëshmitar?

7 PË. Nuk më kujtohet që ta kem parë këtë dokument.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni i informuar në
9 përgjithësi që UÇK-ja komunikonte me publikun ose bashkësinë
10 ndërkombëtare përmes kumtesave, njoftimeve për shtyp,
11 deklaratave për shtyp? A jeni njohur me këtë praktikë?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se do të shihni
14 paragrafin e parë, në të jepet kontekst lidhur me faktin se
15 kur dhe ku z. Kastrati dhe Desku janë arrestuar. Ndërkohë që
16 në qoftë se do të lexoni paragrafin e dytë, aty thuhet që:

17 "Sipas Informacionit të Shërbimit Informativ të UÇK-së
18 për veprimtarinë e tyre kundër luftës çlirimtare të UÇK-së të,
19 të lartpërmendur kanë propaganduar për dorëzimin armëve në
20 bashkëpunim me kolaboracionistët, me Selman Biniqin, nga
21 fshati Banjë, dhe Ramiz Hoxha nga Bellanica, kohë më parë të
22 ekzekutuar nga UÇK-ja. Si dhe janë në koordinim të vazhdueshëm
23 me Agim Krasniqin, anëtar i kryesisë së LDK-së, i cili
24 Shërbimit Informativ të UÇK-së i është njohur si inspirues i
25 luftës speciale kundër UÇK-së dhe nismëtar i një farë policie

1 autonomiste të Kosovës.”

2 Pra, këto dy gjëra që thuhën këtu përkatësisht që
3 informacioni është marrë dhe është ofruar nga shërbimi
4 inteligjent i UÇK-së. A është në pajtim ky informacion me atë
5 çfarë keni thënë më herët, që ju keni pasur informacion në atë
6 kohë që ekzistonte një shërbim i inteligjencës i UÇK-së?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu ngrihen disa
9 pretendime ose akuza ndaj këtyre individëve, të tilla si për
10 shembull, shpërndarjen e propagandës, shpërndarjen e armëve,
11 dorëzimin e armëve. A e shikoni këtë gjë, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini ju arsyen se pse
14 UÇK-ja ishte kundër civilëve që të dorëzonin armët e tyre?

15 PË. Thjesht mund ta marr me mend. Mund të spekuloj. Por nuk e
16 di me siguri.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'jua bëj ndryshe
18 pyetjen atëherë. Një kabllogram që e keni parë dje, që është
19 prova materiale P1073, në qoftë se doni mund t'jua tregoj por
20 edhe mund t'ju lexoj pjesën përkatëse. Është një kabllogram i
21 26 dhjetorit 1998 dhe në të thuhet që:

22 “Aktualisht UÇK-ja nuk duket fare e interesuar që të
23 shmangë konfliktin dhe mund të mirëpresë mbërritjen e saj.”

24 Nuk e di a e keni dëgjuar këtë gjë në 1998?

25 PË. I qëndroj kësaj. Nuk është se e kam përpara, por nuk mund

1 t'ju them se çfarë kam dashur të them sot pas 25 vitesh se
2 çfarë kuptimi ka pasur fjala "conflict". Nuk e di në qoftë se
3 bëhej fjalë për marrëdhënie ndërmjet UÇK-së dhe LDK-së apo për
4 konfliktin më të gjerë me forcat e sigurimit serb.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'jua bëj në këtë
6 mënyrë pyetjen atëherë.

7 Deri në fund të dhjetorit 1998, a e keni kuptuar ju
8 faktin që situata ka qenë e tillë që disa palë të UÇK-së
9 shpresonin që konflikti ndërmjet tyre dhe forcat serbe do
10 tërhiqnin bashkësinë ndërkombëtare në këtë konflikt?
11 Domethënë, me fjalë të tjera dhuna ishte pjesë e strategjisë?
12 PË. E di që jemi që të gjithë mezi ç'presim që të ikim për
13 fundjavën e Pashkëve, megjithatë në qoftë se do të më lejoni
14 dua që të jap një shpjegim pak më të hollësishëm lidhur me
15 këtë pyetje.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, patjetër.

17 PË. Këtu konteksti është shumë i rëndësishëm. Pika e parë që
18 dua të ngre është që të dyja palët, serbët, domethënë,
19 Beogradi i Milosheviqit dhe në veçanti UÇK-ja, padiskutim që
20 nuk kishin besim tek njëra-tjetra. Të dyja palët prisnin
21 pavarësisht marrëveshjes së 30 tetorit dhe armëpushimit ne e
22 dimë që ky ishte një armëpushim i vështirë dhe MVK-ja po
23 mundohej që të ndërhynte. Ata parashikonin që të kishte më
24 shumë luftime në pranverë nga të dyja anët. Dhe këtu dua që të
25 shtoj një poshtëshënim, ne i kemi dëgjuar këto mendime, këto

1 ide si nga serbët, të tillë si Streten Lukic i cili shumë
2 shprehimisht në mënyrë të drejtpërdrejt thoshte që UÇK-ja do
3 të godiste përsëri në pranverë. Marsi konsiderohej si fillimi
4 i sezonit të luftimeve, në qoftë se do të shprehesha kështu.

5 Këtë e kemi dëgjuar gjithashtu edhe nga kontaktet tona në
6 trojkë. Dhe më në përgjithësi nga UÇK-ja dhe zyrtarët e tjerë
7 me të cilët jemi takuar. Në të njëjtën kohë, ne ishim të
8 informuar, ishim të ndërgjegjshëm edhe ne edhe MVK-ja, akoma
9 edhe më shumë sesa ne, sepse ata kishin shumë herë më tepër
10 burime sesa kishim ne. Ne kishim vetëm pesë deri në gjashtë
11 nëpunës në atë pikë. Pra, ndërkombëtarët të tillë si MVK-ja
12 ose KDOM-i e dinin që të dyja palët po përgatiteshin për
13 luftime të mundshme. Për shpërthime të mundshme luftimesh
14 aktive.

15 MVK-ja monitoronte kufirin dhe ata raportonin rastet e
16 forcave serbe të cilët pra merrnin armatime dhe që lëviznin.
17 Kështu që me fjalë të tjera, ne po ashtu edhe nga ana e UÇK-së
18 përmes udhëheqësve të UÇK-së merrnim informacion që ata po
19 riorganizonin forcat e tyre, po rekrutonin dhe po përpiqeshin
20 që të merrnin më shumë armë nga Shqipëria dhe nga Maqedonia.
21 Kishin hapur një tjetër rrugë për kontrabandimin e armëve në
22 mal që ishte një rrugë që bënte ndarjen e Kosovës nga
23 Maqedonia që quhet rruga e Sar Planinës. Atëherë, ishte rruga
24 e Sharrës ajo e cila ishte hapur në mënyrë të tillë që të mund
25 të bëhej kontrabandimi i armëve.

1 Kështu më duhet të them që në veçanti udhëheqësit e
2 Shtabit të Përgjithshëm dhe trojka ishim absolutisht të
3 angazhuar që ta bënim armëpushimin që të funksiononte.
4 Megjithatë, nga ana tjetër ne ishim të shqetësuar për faktin
5 që serbët do nisnin një tjetër sulm. Do të nisnin luftimet
6 përsëri në pranverë dhe ata mbështesin përpjekjet për t'u
7 përgatitur për këtë me trupat e tyre.

8 Megjithatë, kini parasysh që këtë po e them unë sot. Jam
9 unë, Shaun Byrnes, që po mundohem që të bashkoj gjëra, të lidh
10 zhvillimet në atë kohë. Duhet ta keni parasysh këtë gjë. Të
11 dyja palët në nivel vendor provokonin njëra-tjetrën. Unë
12 personalisht nuk kam parë asnjë provë dhe nuk kam dëgjuar
13 asnjë provë që udhëheqësit e UÇK-së në kontekstin e trojkës
14 kanë pasur udhëzime për ta bërë këtë gjë. Domethënë që
15 udhëzimet për ta bërë këtë gjë vinin nga drejtuesit ose
16 udhëheqësit e UÇK-së. Prezumimet tona ishin që udhëzimet për
17 të sulmuar pikat e policisë serbe ishin kryesisht patrullat e
18 policisë serbe në rrugë. Dhe këto veprime në fakt kishin si
19 autorë kryesorë oficerë ose ushtarë lokalë të UÇK-së. Nuk
20 është se kam asnjë dëshmi. Nuk është se kam asnjë provë për ta
21 mbështetur këtë.

22 Unë do të sugjeroja që MVK-ja kishte shumë herë më tepër
23 burime në atë kohë dhe që po monitoronte apo kishte
24 përgjegjësinë e vet që të realizonte monitorimin, mbështetur
25 në marrëveshjen e 30 tetorit. Domethënë, me fjalë të tjera,

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 15

1 MVK-ja është një burim shumë herë më i mirë informacion sesa
2 jam unë personalisht. Këto janë thjesht mendimet e mia sot.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit
4 shumë për mendimet.

5 Tani në kabllogram, që është prova materiale P1067,
6 thuhet arsyet e mëposhtme, siç i keni kuptuar ju, të
7 arrestimit të z. Kastrati dhe të z. Desku. Do t'jua lexoj dhe
8 pastaj do ju bëj një pyetje. Thuhet si më poshtë:

9 Për procesverbal është në faqen 075301.

10 "Politikisht, UÇK-ja kërkon që të rrisë njohjen e vet
11 ndërkombëtare si faktor 'përcaktues' në Kosovë. Presidenti
12 Rugova dhe diskutimet, negociatat me bashkësinë ndërkombëtare
13 synonin që të arrinin një zgjidhje politike të çështjes së
14 Kosovës. Arrestimi i dy liderëve të LDK-së në Malishevë nga
15 UÇK-ja ngre në pah synimin për politikën lokale për të
16 dominuar dhe për të kontrolluar si dhe ngre çështjen e
17 gatishmërisë së tyre për të toleruar partitë politike dhe
18 pikëpamjet e tyre."

19 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjë, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A i qëndroni të njëjtit
22 mendim edhe sot?

23 PË. Nuk e di në qoftë se do të më lejoni që të shtjelloj pak
24 më tepër këtë përgjigje.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, patjetër.

1 PË. Unë e mendoj sot, e kam menduar edhe gjatë viteve, ndër
2 vite, se kishim të bënim kryesisht me një konflikt ose ta them
3 ndryshe, tani në këtë pikë kohe kur bashkësia ndërkombëtare
4 ishte e përfshirë në konfliktin ose problemin e Kosovës ajo
5 çfarë ishte një temë shumë e diskutueshme në atë kohë ishte që
6 kush do ta qeveriste Kosovën pas përfundimit më të madh me
7 Serbinë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Dua t'ju
9 tregoj një tjetër dokument. E keni parë shumë shkarazi këtë
10 dokument. Kështu që dua që ta shikoni dhe dua që t'ju pyes
11 lidhur me aspekte të caktuara të saj. Është prova materiale
12 P1090.

13 Besoj se e kujtoni këtë dokument, z. Byrnes. Ju treguat
14 shkurtimisht që bëhej fjalë, domethënë që ky dokument ishte
15 procesverbal i një takimi që z. Rossin pati me përfaqësues të
16 UÇK-së në Gjenevë. A ju kujtohet ta keni parë këtë dokument më
17 herët këtë javë, z. Byrnes?

18 PË. Po. Më kujtohet.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
20 kalonim pak më poshtë në këtë faqe. Besoj se do e shihni këtu
21 që këtu jepet një raportim i këtij takimi sa i takon se kush
22 ishte i pranishëm aty nga UÇK-ja. Dhe thuhet në këtë dokument
23 që:

24 "Sipas Byrnes, ekzistoi një bashkëpunim shumë i mirë në
25 terren."

1 A mund të konfirmoni në terma të përgjithshëm, z. Byrnes,
2 që ju keni pasur bashkëpunim shumë të mirë me udhëheqësit e
3 UÇK-së, sa i takon çështjeve që ishin shqetësuese për ju?
4 PË. Siç ju thashë edhe në një koment të mëhershëm këtë javë,
5 ne kishim problemet tona, kishim mosmarrëveshjet tona, por në
6 përgjithësi bashkëpunimi ka qenë i kënaqshëm, veçanërisht me
7 trojkën.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen e dytë të
9 këtij dokumenti. Ka një paragraf këtu që do ju lutesha ta
10 shihni z. Byrnes. Fillon me fjalën: "Ndalimi i dy anëtarëve të
11 LDK-së ..." E shihni këtë?

12 Thuhet:

13 "Ndalimi ..."

14 Dhe edhe një herë këto janë fjalë që i atribuohen z.
15 Rossin, me sa duket. I ka thënë ai. Thotë:

16 "Ndalimi i dy zyrtarëve të LDK-së është edhe një
17 shqetësim për ne. Ne besojmë se ky është një cenim i të
18 drejtave të njeriut. Kjo krijon përshtypjen se UÇK-ja nuk po
19 luan rolin e një force demokratike në këtë proces."

20 Pyetja e parë që kam unë është kjo: A e keni ngritur edhe
21 ju shqetësime të ngjashme me këta anëtarë të trojkës apo të
22 udhëheqjes së UÇK-së që sipas jush, t'ju thojë pra, kjo nuk
23 përputhet me vlerat demokratike?

24 PË. Po, e kam bërë edhe unë. Në disa raste madje.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe me anëtarë të trojkës?

1 PË. Po, edhe me ata.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

3 Vazhdojmë. Këtu vazhdon biseda, diskutohet ky problem dhe
4 një nga anëtarët e delegacionit të UÇK-së thotë si në vijim --
5 pra ja thotë z. Rossin për zyrtarët e LDK-së i thotë:

6 "Sa i takon ..."

7 E shihni? E shihni në mes të faqes?

8 PË. Po, e shoh.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet si në vijim:

10 "Sa i takon arrestimit të dy 'zyrtarëve' të LDK-së, në
11 këtë rast kemi të bëjmë me dy spiunë, bashkëpunëtorë të
12 aparatit represiv serb. Janë arrestuar sepse kanë dëmtuar
13 kauzën tonë. Asnjë forcë politike nuk e ka dënuar arrestimin e
14 këtyre spiunëve, të Kastratit dhe të Deskut. Në çdo shtet
15 njësoj do ishte vepruar. Shtetet e Bashkuara, po ashtu do t'i
16 kishin arrestuar shtetasit amerikanë të cilët spiunonin si për
17 shembull, për Rusinë!"

18 Kjo deklaratë a përputhet me pretendimet që ju tha dhe z.
19 Mahmuti dhe të cilat ju i keni zbardhur në kabllogramin që ne
20 pamë para një çasti?

21 PË. Do të më duhet ta shihja edhe një herë. Por nuk më
22 kujtohet. Dhe tani që po e shoh, nuk mbaj mend që të t'i ketë
23 thirrur spiunë këta zyrtarë të LDK-së. Por po e le me kaq. Po
24 e le me kaq.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po për bashkëpunëtorë, për

1 faktin që ishin bashkëpunëtorë a ju kujtohet kjo? Po kumtesa
2 që ju lexova, a ju kujtohet?

3 PË. Po në vija të përgjithshme për këtë flitej në kumtesë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas jush, z. Desku dhe
5 z. Kastrati a ishin spiunë apo bashkëpunëtorë të qeverisë
6 serbe?

7 PË. Në pikëpamjen time po thoni? Kjo është pyetja juaj?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

9 PË. Nuk e kam idenë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, s'keni ndonjë
11 informacion që mund t'u tregonte se këta persona kishin
12 spiunuar apo kishin bashkëpunuar me qeverinë serbe?

13 PË. Absolutisht jo.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu thuhet që z. Rossin
15 është përgjigjur si në vijim. Është në paragrafin më poshtë
16 dhe do të doja që të shfaqej e gjithë faqja për ju. Thuhet:

17 "Demaçi ka refuzuar që të vizitohen të burgosurit nga
18 UÇK-ja nga ana e Kryqit të Kuq. Unë do t'ju thosha se nëse do
19 të bëhet ndonjë proces juridik, ai duhet të jetë i hapur dhe i
20 drejtë. UÇK-ja mund të krijojë kushtet që Kryqi i Kuq
21 Ndërkombëtar t'i vizitojë të burgosurit. Serbia ka lejuar që
22 të vizitohen burgjet e saj. Unë ua le si sugjerim që t'u
23 mundësohet vizita pjesëtarëve të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.
24 Si mund të vizitohen të burgosurit e të mos dihet vendi i
25 burgut?!"

1 A i keni bërë edhe ju kërkesa të ngjashme udhëheqjes së
2 UÇK-së që të lejohej Kryqi i Kuq Ndërkombëtar të vizitonte të
3 burgosurit e UÇK-së?

4 PË. Jo, nuk më kujtohet diçka e tillë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim përgjigjen e z.

6 Bardhi këtu, paragrafi më poshtë e cila është kështu:

7 "Për këtë çështje Shtabi i Përgjithshëm është kompetent e
8 jo ne, madje as Demaçi. Prandaj, ne vetëm mund t'ia
9 transmetojmë këtë informacion Shtabit të Përgjithshëm. Ajo
10 është çështje e tyre."

11 E shihni këtë?

12 PË. Po, e shoh.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A përputhet kjo me mënyrën
14 si e kishit kuptuar edhe ju? Pra, që kjo ishte një çështje për
15 të cilën duhet të vendoste Shtabi i Përgjithshëm?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt a ka ndodhur që
18 një sërë të -- një pjesë e të burgosurve -- një pjesë të
19 burgosur -- një pjesë prej të burgosurve në fakt u vizitua nga
20 Kryqi i Kuq Ndërkombëtar?

21 PË. Nuk kem dijeni për këtë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Flasim për lirimin e z.

23 Desku dhe z. Kastrati dhe do të doja të komentoni

24 shkurtimisht lidhur me dy dokumente. Dokumenti i parë është

25 SPOE00225269.

1 Po ju jap një çast ta lexoni z. Byrnes, dhe më thoni kur
2 të keni përfunduar. Do ta hapim faqen të plotë.

3 PË. E lexova.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem, të shkojmë pak
5 më poshtë që ta shoshim dokumentin e plotë. Besoj se pajtoheni
6 me mua që ky është një aktvendim i gjykatësit hetues i UÇK-së
7 i 7 nëntorit 1998, edhe ka të bëjë me z. Kastrati dhe z.
8 Desku. Paragrafi i parë thotë që:

9 "Gjykatësi hetues -- gjykatësi hetues i Gjykatës
10 Ushtarake, bazuar në informacione nga UÇK-ja, Shërbimi i
11 Zbulimit SHIK, Shërbimi Informativ, kapitulli 8, pika 4" e në
12 vijim, thotë se "do të vijojë me hetimet ndaj z. Kastrati dhe
13 Desku dhe pastaj tek pjesa e arsytimit shprehet që:

14 "Që nga fillimi i ofensivës së armikut të lartpërmendurit
15 kanë bërë luftë speciale kundër UÇK-së dhe luftës së popullit
16 tonë për liri dhe pavarësi. Kanë arsyetuar qyqarllëkun e tyre
17 dhe të partisë që ata i përkasin, gjithnjë duke penguar
18 angazhimin e popullit në luftën për liri. Kanë përhapur
19 pasiguri dhe defetizëm kudo që kanë shkuar. Nuk kanë ndihmuar
20 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, përkundrazi, e kanë penguar
21 dhe sabotuar luftën e saj të drejtë."

22 E shihni këtë?

23 PË. Po, e shoh.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Së pari do t'ju bëj këtë
25 pyetje: E keni parë ndonjëherë më përpara këtë dokument?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 22

1 PË. Jo, nuk e kam parë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A përputhet kjo me
3 pretendimet që bëri z. Mahmuti kur tha se këta dy persona në
4 fakt do të gjykoheshin?

5 PË. Përputhet, të paktën sipas meje.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretares të
7 nxjerrë në ekran dokumentin 1D47.

8 Po ju jap një çast ta lexoni, Dëshmitar. Është Komunikata
9 nr. 63 e Shtabit të Përgjithshëm dhe mban datën 27 nëntor
10 1998, dhe është e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ju lutem
11 lexojeni me mendje, pa zë pra, dhe më thoni kur të keni
12 përfunduar.

13 PË. E lexova.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë është
15 kjo: A e keni njohur këtë dokument në atë kohë apo e keni
16 pasur mundësi ta shihni më pas?

17 PË. E kam parë për herë të parë këtë dokument këtu në Hagë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po s'e keni parë më
19 përpara?

20 PË. Jo, nuk më kujtohet ta kem parë më përpara.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me mua se nga
22 përmbajta e këtij dokumentit kuptohet se është Shtabi i
23 Përgjithshëm përmes një amnistie që vendos të lirojë këta dy
24 persona, dy anëtarët e LDK-së, Cen Desku dhe z. Kastrati dhe
25 dy gazetarët e Tanjugut? A pajtoheni me mua?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 23

1 PË. Të pajtohem me çfarë?

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që në këtë dokument mesa
3 kuptohet nga ky dokument, Shtabi i Përgjithshëm është ai që ka
4 vendosur për lirimin e tyre?

5 PË. Po kështu thuhet në dokument.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sipas dokumentit këtë
7 e kanë bërë përmes një amnistie?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ka ndonjë gjë në
10 dokument që ju mendoni se nuk përputhet me përvojën që keni
11 pasur ju apo komunikimin që keni pasur ju me Shtabin e
12 Përgjithshëm sa i takon aspekteve të tilla?

13 PË. Unë mund t'ju them këtë në thelb ky është një dokument
14 politik i cili ka për synim ta vendosë në pozitë shumë të
15 favorshme Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në sytë e
16 ndërkombëtarëve, veçanërisht për misionin e OSBE-së i cili
17 ishte duke u krijuar.

18 Po unë mund të shtoj këtë, që unë kam -- jam i bindur që
19 amnistia që ka bërë, ka dekretuar Shtabi i Përgjithshëm për dy
20 gazetarët e Tanjugut ka qenë si rezultat i presionit që i
21 ishte bërë trojkës dhe përmes trojkës Shtabit të Përgjithshëm
22 si nga SHBA-ja dhe KDOM-i, pra si nga BE-ja dhe nga KDOM-i i
23 SHBA-së edhe misioni i ri i MVK-së që drejtohej nga Ambasadori
24 Walker.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk e di a pajtoheni me

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 24

1 mua që amnistia dhe lirimi i këtyre katër personave u përdor
2 nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së si një formë marrëdhënie
3 publiku në sytë e ndërkombëtarëve, për t'ju treguar
4 ndërkombëtarëve se ata kishin një aspekt të marrëdhënies me
5 publikun?

6 PË. Po, pajtohem.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do të flasim për një
8 incident tjetër ku keni qenë ju i përfshirë. Flasim këtu për
9 inspektorin e policisë Goran Zbilic. Ju kujtohet ky rast?

10 PË. Po, më kujtohet.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 PË. Vagullt, vagullt më kujtohet. Këto diskutime këtu janë
15 goxha intensive dhe të lodhshme, por mbaj mend që më ka pyetur
16 për diçka të tillë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të doja t'ju pyesja për
18 diçka që keni thënë gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë
19 javën e kaluar që është Shënimi Përgatitor numër 2, në
20 paragrafin 37, i cili ka ERN 120148. Këtu është zbardhur kjo
21 bisedë. Ju keni thënë:

22 "Nëse UÇK-ja e konsideronte dikë oficer të policisë
23 serbe, kjo donte të thoshte se ky person ishte -- konsiderohej
24 si tradhëtor."

25 A pasqyron kjo vërtetë pikëpamjen tuaj dhe a pasqyron

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 25

1 saktësisht atë që i keni thënë Prokurorisë?

2 PË. Po. Në fakt, termi "armik" do të ishte term më i mirë

3 sesa termi "tradhtar" në fakt. Por, nuk e mbaj mend tamam-

4 tamam nëse kam thënë atë term dhe "armik" e kam thënë para 25

5 vitesh. Por, sidoqoftë policët serbë 100 për qind

6 konsideroheshin armiq.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sipas jush, ishte e

8 njëjta gjë edhe për Goran Zbilic?

9 PË. Absolutisht po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju i thatë z. Misetic që

11 shkuat tek Remi, Rustem Mustafa, në mënyrë që të mundësonit

12 lirim të këtij personi, kështu?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Remi a ju tha se kë

15 pyeti që të merrte autorizim nëse pyeti ndokënd, pra, të

16 merrte autorizim për ta liruar këtë person?

17 PË. Nuk më kujtohet diçka e tillë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem Sekretares së

19 Gjykatës të nxjerrë në ekran materialin P841. Edhe këtë

20 dokument ju e keni parë shkurtimisht, z. Byrnes, në fillim të

21 kësaj jave.

22 Është procesverbali i një konference për shtyp ku ka qenë

23 Adem Demaçi dhe Ibrahim Rugova. Nga përmbajtja, e do të doja

24 që të merrja për të mirëqenë fjalën time, por ju mund ta

25 lexoni dhe vetë, pra kjo konferencë i bie të jetë bërë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 26

1 menjëherë pas lirimimit të z. Zbilic, që i bie rreth datës 23
2 janar 1999.

3 Shkojmë në faqen 2 të dokumentit.

4 Është një aspekt paraprak për të cilin do të doja t'ju
5 pyesja. E shihni paragrafin e dytë në këtë faqe që fillon:

6 "/Përkthim/ Nuk dua t'ju lodh më shumë. Nuk dëshiroj më
7 tutje që t'ju lodh."

8 E shihni këtë?

9 PË. Po e shoh.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu po flet z. Demaçi në
11 këtë rast dhe është zbardhur kështu:

12 "Unë nuk dëshiroj më tutje që t'ju lodh, por mund t'ju
13 them se ju falënderoj për të gjitha këto komunikime që kemi. I
14 falënderoj të tre gazetatat tona ditore që i kemi për një
15 raportim objektiv që po japin, dhe në emër të UÇK-së lutem
16 shumë gazetarëve, gazetave që komunikatat zyrtare që dalin nga
17 Shtabi i Përgjithshëm të mos amputohen, të mos shkurtohen
18 sepse ato janë të rralla, nuk janë të shpeshta e janë
19 dokumente zyrtare me të cilat duhet të njihet opinioni edhe
20 shqiptar edhe serb edhe ai botëror."

21 Tani pyetja ime e parë është kjo:

22 A keni ditur ju që UÇK-ja i trajtonte komunikatat e veta
23 si dokumente zyrtare?

24 PË. Jo, tamam. Por, kur na sillnin në vëmendje dokumente të
25 tilla, të gjitha këto dokumente evidentoheshin si memo zyrtare

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 27

1 kështu që edhe ne prezumojmë që këto ishin dokumente zyrtare.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3 të
3 dokumentit.

4 Shikoni poshtë minutazhit 10:53. Tek 10:53.

5 E shihni minutazhin?

6 PË. Të shoh çfarë?

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I shihni minutat 10:53?

8 PË. Po e shoh.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E shihni këtu që është një
10 gazetar dhe bën një pyetje lidhur me lirimin e Goran Zbilic,
11 që sapo kishte ndodhur dhe ai thotë që "Familja, të afërmit e
12 Nebojsa Radosevic dhe Kico Dobricic po shprehin dyshimet e
13 tyre nëse këta dy persona janë ende gjallë, pavarësisht se ju
14 pretendonit të kundërtën."

15 Tani përgjigja e z. Demaçi është kështu:

16 "Më lejoni t'ju garantoj ju dhe familjen tuaj të cilët e
17 mirëkuptoj, unë e di sesa shumë shqetësohen edhe mamaja ime
18 dhe motra ime për mua, pavarësisht se më takojnë një herë në
19 muaj. Unë e di se çfarë do të thotë të jetë në burg. Unë ju
20 garantoj se dy gazetarët në fjalë janë shëndoshë e mirë. Po
21 trajtohen në mënyrë njerëzore në këto -- duke marrë parasysh
22 rrethanat e luftës dhe kështu me radhë. Po ju them këtë në
23 mënyrë që t'ua përcillni këtë mesazh personave të shqetësuar."

24 Pastaj vazhdon dhe thotë:

25 "Ne po bëjmë ç'të mundemi, po luajmë rol humanitar, po

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 28

1 bëjmë ç'të mundemi në mënyrë që të zbusim vuajtjet e tyre."

2 Pastaj tregon përvojën e vet dhe më poshtë thotë:

3 "Sidoqoftë, unë nuk kam të drejtë të ndërhyj në këtë
4 çështje. Unë mund të ndërhyj vetëm si një person, si një
5 humanitar dhe të bëj propozime të mira. Ju e dini shumë mirë
6 që nuk është në dorën time."

7 E shihni këtë?

8 PË. Po. E shoh.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A përputhet kjo edhe me
10 atë që kishit kuptuar ju sa i takon kompetencave të kufizuara
11 që kishte z. Demaçi?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3 të
14 këtij dokumenti. Këtë po e jap që të kuptoni kontekstin
15 fillimisht. Shkojmë në fund të faqes.

16 Këtu bëhet prapë pyetje për z. Zbilic, z. Byrnes, dhe
17 komunikimi që kishte filluar mes z. Demaçi dhe z. Milutinovic
18 në Serbi në mënyrë që të keni kontekstin e asaj që po përpiqem
19 të them.

20 Shkojmë te faqja tjetër. Ju lutem shkoni pak më lart,
21 Sekretare, që ta lexoni z. Byrnes. Z. Byrnes, lexoni në 18:48
22 që ta kuptoni të gjithë kontekstin dhe më thoni pastaj kur të
23 keni mbërritur në fund të faqes.

24 PË. E lexova. A mund t'ju bëj unë një pyetje.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

1 PË. Por, mbase as ju s'e keni përgjigjen. Unë besoj që
2 gazetari që bën këtë pyetje është nga gazetatat e Prishtinës,
3 nuk është gazetar serb.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se keni të drejtë,
5 z. Byrnes. Pyetja ime është kjo: Ju e shihni që këtu po
6 diskutohet çështja e z. Zbilic. Z. Demaçi, e shohim këtu te
7 minuta 19:42, u shpjegon që ai nuk ka qenë atje kur është
8 liruar z. Zbilic edhe ka dhënë një deklaratë ku ka thënë se
9 ishte trajtuar mirë.

10 Dhe ai thotë:

11 "Dhe unë besoj ..." dhe citoj fjalët e tij, nëse ishin
12 vërtetë fjalët e tij, që ka thënë z. Zbilic, "siç mund ta
13 shihni kjo shihet që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka
14 vendosur të pranohet lutja ime, të pranohet përpjekja ime që
15 të kihet një mirëkuptim për këta njerëz dhe thirrja ime është
16 shpaguar 100 fish."

17 A pajtoheni me mua që kjo tregon se z. Demaçi kishte bërë
18 thirrje, kishte ndërhyrë pra me Shtabin e Përgjithshëm që të
19 lirohej z. Zbilic dhe se Shtabi i Përgjithshëm kishte rënë
20 dakord dhe kishte pranuar ta lironte këtë person bazuar në
21 këtë paragraf që lexuam?

22 PË. Unë nuk e di. Nuk kam qenë tek Shtabi i Përgjithshëm
23 vetë. Nuk e di se çfarë e ka shtyrë Shtabin e Përgjithshëm që
24 të merrte atë vendim. Por ama i kthehem pikës që thashë pak më
25 herët, ndërkombëtarët në Kosovë i kanë bërë shumë presion

1 Shtabit të Përgjithshëm që të lironte edhe z. Zbilic. A ka
2 qenë -- a u bë kjo për shkak të presionit apo thirrjes së z.
3 Demaçi, unë nuk e di.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt unë s'e bëra shumë
5 mirë pyetjen. Unë e vlerësoj përgjigjen tuaj.

6 Por pyetja ime është kjo: A pajtoheni ju që sipas asaj që
7 thotë -- sipas asaj që thotë z. Demaçi vendimi për të liruar
8 z. Zbilic është marrë prej Shtabit të Përgjithshëm dhe jo prej
9 tij?

10 PË. Po. Kështu është. Më falni, ju kërkoj ndjesë që ju
11 ndërpres. Dua të shtoj, ajo që është veçanërisht interesante
12 në këtë situatë është fakti që z. Demaçi ka qenë vetë nga zona
13 e Podujevës, në zonën e Llapit dhe ka qenë shumë i njohur.
14 Edhe kishte shumë influencë në UÇK-në e Llapit.

15 Dhe po përpiqem që të bëj mozaikun bashkë këtu. Thirrja e
16 tij fillimisht iu drejtuar komandantit të zonës së Llapit. Ai
17 fillimisht kontaktoi z. Remi që të lironte inspektorin Zbilic
18 dhe mesa duket sa në vesh të shurdhët thirrja e tij e parë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E vlerësoj këtë që thatë.

20 Tani do t'ju pyes për një dokument tjetër që i takon --
21 që lidhur me Rrustem Mustafën, me Remin pra, dhe është prova
22 materiale P10.

23 Po ju them shkurtimisht se çfarë është dhe z. Byrnes do
24 ju jap një moment ta lexoni. Po kjo është një amnisti e datës
25 5 prill 1999. Mund ta shihni që është nënshkruar nga

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 31

1 komandanti i zonës së Llapit, Remi. Pra, Mustafa është me
2 numër -- ka numrin 003/04/99 për zonën e Llapit. Rendit këtu
3 një numër personash që janë ose kanë qenë të ndaluar nga UÇK-
4 ja për një periudhë të caktuar kohore. Sidoqoftë po ju jap pak
5 kohë ta lexoni dhe më thoni kur të keni shkuar në fund të
6 faqes në mënyrën që të kalojmë në faqen e radhës.

7 PË. Kam unë një pyetje tani të shpejtë. 4 prill është? Nuk e
8 di data është formati evropian a amerikan?

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është formati evropian, 5
10 prill 1999. Nuk është formati amerikan.

11 PË. Faleminderit.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë, në
13 mënyrë që ta lexojë dëshmitari. Faleminderit. Në faqen e
14 radhës, ju lutem.

15 PË. E lexova. Por pashë një gjë tek i burgosuri i parë. Ka
16 mundësi të ketë një pasaktësi.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, ka një pasaktësi. Por
18 do të flasim për atë. Shkojmë pak në faqen e parë. Keni shumë
19 të drejtë, z. Byrnes, dhe do ta korrigjoj për procesverbal. Në
20 fakt emri i parë që thotë Hoti, thuhet që ka qenë paraburgim
21 që është prej 1999, por në fakt duhej të ishte shënuar që ka
22 qenë prej 18 nëntorit 1998.

23 PË. Faleminderit.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur jeni takuar ju me z.
25 Remi a ju tha ai se i ka mbajtur të ndaluar këta persona? A ju

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 32

1 tha ai që disa prej këtyre personave kishin goxha kohë që
2 qëndronin të burgosur? Pra, i bie që në momentin që ka dalë ky
3 dokument i takonte që këta persona të kishin gjashtë muaj nën
4 ndalimin e UÇK-së. A ju ka thënë ai gjë në lidhje me këta
5 persona?

6 PË. Jo, nuk më ka thënë. Por kjo është hera e parë që unë e
7 shoh këtë dokument dhe gjithashtu unë nuk kam qenë në dijeni
8 që ka pasur të ndaluar të rrëmbyer në zonën e Llapit. Dhe pika
9 e tretë MVK-ja e OSBE-së ka qenë përgjegjëse, tërësisht
10 përgjegjëse në këtë periudhë kohore për këto lloj aspektesh,
11 për këto lloj veprimesh. Nëse ka pasur takime mes Remit,
12 shtabit të tij dhe ndërkombëtarëve, atëherë këto takime
13 mbaheshin me Ambasadorin Walker të MVK-së dhe stafin e tij.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt iu përgjigjët edhe
15 pyetjes time të radhës, por këta anëtarë të udhëheqjes së UÇK-
16 së që takuat ju, asnjëherë nuk ju thanë ju që po mbanin të
17 ndaluar këta persona?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se sërish iu
20 përgjigjët pyetjes sime, por ju nuk e dini se çfarë bëri Remi
21 me këta persona, dhe nëse në të vërtetë i liroi këta persona?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem, përqendrohuni te
24 paragrafi i parë, ku thuhet që:

25 "Në bazë të komunikatave politike të Shtabit të

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses (Vazhdim)

Faqe 33

1 Përgjithshëm të UÇK-së, Rregullores së Brendshme të UÇK-së,
2 Rregullores mbi Administrimin Civil, komandanti i [zonës
3 operative të Llapit] me anën e vendimit numër 003/04/99 ...
4 shpall amnisti për këta persona ...”

5 E shihni këtë?

6 PË. Po, e shoh.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a e pranoni nga fjalët
8 që janë në këtë dokument që z. Mustafa e shpalli këtë amnisti
9 në bazë të autoritetit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që
10 rridhte nga komunikatat politike, rregulloret e brendshme,
11 rregullorja mbi administrimin civil? Jeni dakord me këtë?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kemi arritur momentin
14 për të bërë pushimin për ditën e sotme për paradite, z.
15 Byrnes.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Trupit Gjykses
18 që të na tregojë pak si do të jetë orari i ditës së sotme, pra
19 kur do të jenë pushimet?

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, tani do
22 të kemi gjysmë ore pushim, në orën 11.00. Po gabimi im atëherë
23 se duhet të kishim filluar pushimin që më përpara, por po
24 gjysmë ore pushim tani.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Gjysmë ore pushimi tani?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

2 Sekretare e seancës tregojini dëshmitarit që pushimi nuk
3 do të jetë prej 15 minutash po prej 30 minutash.

4 Seanca shtyhet deri në orën 11.30.

5 --- Pauza fillon në orën 11.04

6 --- Seanca rifillon në orën 11.30

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
8 Seancës, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
11 z. Byrnes. Do të vijojmë me pyetjet e Gjykatësit Mettraux.

12 Gjykatësi Mettraux, fjala për ju.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
14 Smith, dhe mirëdita dhe një herë, z. Byrnes. Dhe që t'ju
15 vendos në kontekst sërish, kemi ende tre ngjarje apo incidente
16 për të diskutuar së bashku. Dhe do të fillojmë me ngjarjen që
17 ka të bëjë me lirimin e tetë ushtarëve serbë.

18 A e mbani mend që nga ana e UÇK-së ju jeni marrë në
19 mënyrë të drejtpërdrejtë me z. Jakup Krasniqi si personin e
20 kontaktit në lidhje me atë ngjarje?

21 PË. Po, e mbaj mend.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, i lutem
23 Sekretares së Seancës të vendosë në ekran provën materiale
24 P1093. Pra, z. Byrnes, edhe një herë, ky është një dokument që
25 ju e keni parë, pavarësisht se me shpejtësi, një ditë këtë

1 javë. Dhe na kanë thënë që është dorëshkrim i z. Jakup
2 Krasniqi dhe na është thënë gjithashtu që është sekuestruar në
3 shtëpinë e tij.

4 Do t'ju jap pak kohë që ju ta lexoni, dhe ta lexoni vetë,
5 pra, për veten tuaj, dhe pastaj do t'ju bëj pyetjen.

6 Siç mund ta shihni z. Byrnes, është në fakt një rrëfim
7 personal i kësaj ngjarjeje në të cilën janë përfshirë tetë
8 ushtarë serbë. Dhe në paragrafin e dytë të kësaj faqeje,
9 personi që shkruan thotë që:

10 "Unë isha personi kyç për negociatat".

11 E shihni atë?

12 PË. Po, e shoh.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në fillim të faqes
14 thuhet:

15 "Ishte fillimi i janarit. Luftimet ishin përqendruar në
16 zonën e Llapit dhe të Shalës. Unë atëherë në cilësinë e
17 zëvendëskomandantit për mbështetje së bashku me Bislim
18 Zyrapin, shefin e SHP-së, Ramë Bujën, kryetarin e Drejtorisë
19 për AC të shoqëruar nga Ferat Shala, më 7 janar ishim në
20 komandën e Shalës."

21 Pyetja ime e parë është: Juve, a ju ishte thënë që z.
22 Krasniqi përveç rolit të tij si zëdhënës në atë kohë ishte
23 emëruar edhe zëvendëskomandant për mbështetje në Shtabin e
24 Përgjithshëm?

25 PË. Jo.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e dytë ka të
2 bëjë me një individ, në fjalinë e dytë, Ferat Shala. A e
3 njihni këtë individ?

4 PË. Jo, nuk e njoh.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po të vijojmë, flitet
6 pastaj për tetë ushtarët serbë të cilët ishin kapur, zënë,
7 thuhet. Dhe këtu thuhet që autori që e ka shkruar, pra, shkoi
8 në Shalë, tek zona e brigadës dhe:

9 "Ne i udhëzuar se si duhet të vepronin pa treguar
10 prezencën tonë aty. Dhe gjatë gjithë këtij, gjatë gjithë kësaj
11 periudhe që zona e Shalës ka qenë e përfshirë në këtë çështje,
12 çdo veprim është bërë në bashkëveprim me SHP-në dhe unë
13 personalisht i kam mbajtur lidhjet me komandant Rrahman
14 Ramën."

15 A e shihni këtë fjali?

16 PË. Po, e shoh.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe mund të konfirmoni që
18 Rrahman Rama ishte komandanti i zonës operative të Shalës, apo
19 jo?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pastaj vijon që:

22 "Ditën e parë ne jemi, kemi bashkërenduar punën me
23 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së me telefon satelitor, që të
24 zënit robër të mund të liroheshin vetëm duke u bërë shkëmbimi
25 i tyre".

1 Dhe pas thuhet që:

2 "Na duhet që të shkonim në Divjakë sepse në mëngjes të
3 datës 9 janar 1999 do të takoheshim me përfaqësuesit e OSBE-së
4 dhe të KDOM-it në Dragobil."

5 A mund të mendojmë, supozojmë, atëherë që këto janë
6 takime në të cilat keni qenë ju i pranishëm në datën 9?

7 PË. Po.

